

VENDIM
Nr.648, datë 29.9.2011

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT
“REPARTI I PRESTARISË DHE ZYRA”, NË ADMINISTRIM TË “NPV USHTRISË”
SHA, TIRANË”, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 82 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit “Repart i prestarisë dhe zyra”, në administrim të “NPV Ushtrisë” sh.a., Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 5 251,4 (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një presje katër) m², nga të cilat 2 071,4 (dy mijë e shtatëdhjetë e një presje katër) m², sipërfaqe funksionale, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për nevojat e Universitetit të Tiranës.

2. Universitetit të Tiranës, pas marrjes në përdorim të pronës së përcaktuar në këtë vendim, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Mbrojtjes dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha